

URDHËR
Nr. 75, datë 30.6.2021

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE PËR MIRATIMIN, PUBLIKIMIN E
PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS DHE TË REGJISTRIT TË KËRKESAVE DHE
PËRGJIGJEVE TË RISHIKUARA**

Në mbështetje të nenit 22, pika 3, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në nenin 19, pika 2, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe të ligjit nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të provës”.

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në pikën 1, të nenit 4, pikat 1 dhe 2, të nenit 5, pikat 1 dhe 2, të nenit 13, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, te Drejtori i Mbikëqyrjes Elektronike, z. Eris Sheshi, si nëpunës më i lartë civil në DPSHP, sipas klasifikimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
2. Ngarkohet z. Eris Sheshi për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**DREJTOR I DREJTORISË SË INSPEKTIMIT
DHE SHËRBIMEVE KOMUNITARE
Anesti Kapllani**